Numër: 10/01 Datë: 05.01.2026

Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (KD i AKK) duke vendosur sipas ankesës të parashtruar me datë 18.08.2025 e të pranuar në AKK me Nr. Prot. 01-606 nga Institucioni **Shoqata e Kontabilisteve të Certifikuar dhe Auditorëve te Kosovës (ShKÇAK) Prishtinë** kundër vendimit të Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve Nr.01-540 29.07.2025. në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Bazuar në nenin 5 paragrafi 8 të Rregullores Nr. 01/196 së punës të Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 22.12.2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Refuzohet** si e pabazuar ankesa me Nr. Prot. 01-606 më datë 18.08.2025, e Institucionit Shoqata e Kontabilisteve të Certifikuar dhe Auditorëve te Kosovës (ShKÇAK) Prishtinë, e ushtruar kundër vendimit të Këshillit Drejtues Nr. 01-540 29.07.2025.

II. Mbetet në fuqi vendimi Nr. 01-540 29.07.2025 i Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve.

III. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Institucioni **Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (ShKCAK)**, pas pranimit të vendimit të Këshillit Drejtues (KD) të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK) nr. 01-540, datë 29.07.2025, ka paraqitur ankesë në AKK me nr. prot. 01-606, datë 18.08.2025, duke shprehur pakënaqësi lidhur me numrin e kuotave/kandidatëve për trajnim.

Pretendimet ankimore lidhen me pikën 1.1 të dispozitivit të vendimit të lartpërmendur, e cila ka të bëjë me numrin e grupeve për sesion trajnimi për kualifikimin **"Teknik i Kontabilitetit", niveli V sipas KKK-së.**

Në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve ka caktuar ekipe të ekspertëve të jashtëm për vlerësimin e institucionit në lidhje me përmbushjen e kritereve për akreditim dhe validim të këtij kualifikimi

Tutje **ShKCAK**, pretendon se edhe pas ngritjes së kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturës, AKK pa ndonjë arsyetim të bazur ka zvogëluar numrin e grupeve dhe të kandidatëve për sesionet e trajnimit për kualifikimin **"Teknik i Kontabilitetit", niveli V sipas KKK-së.**

AKK brenda afateve të përcaktuara dhe dispozitave ligjore në fuqi që rregullojnë çështjen e ankinimit, ka proceduar ankesën në KD për shqyrtim dhe vendimmarrje.
KD – AKK në mbledhjen e radhës pas shqyrtimit të ankesës ka kërkuar sqarime shtesë lidhur me ankesën nga ekipi i ekspertëve të angazhuar në procesin e riakreditimit.

Ekipi aktual i ekspertëve nuk ka kryer më parë vlerësim të ndonjë kualifikimi në SHKÇAK, përfshirë "Teknik i Kontabilitetit". Vlerësimi dhe rekomandimi lidhur me numrin e grupeve janë bërë bazuar në kapacitetet aktuale infrastrukturore të evidentuara, përkatësisht në dy sallat ekzistuese (një për 40 kandidatë dhe një për 50 kandidatë), sipas dokumentacionit të ofruar nga SHKÇAK ("Lista e pajisjeve dhe materialeve në dispozicion për ofrimin dhe vlerësimin e kualifikimit/modulit në përputhshmëri me numrin e kandidatëve").

Tutje, ekipi ka bërë rivlerësimin e raportit të akreditimit dhe validimit në përputhje me rregulloret në fuqi. Megjithatë, nuk mund të rekomandohet rritja e numrit të grupeve pa mbështetje faktike në kapacitetet infrastrukturore, për shkak të numrit të kufizuar të sallave në raport me numrin e kualifikimeve që ofron SHKÇAK.

AKK bazuar në nenin 18 të Ligjit Nr/03/L-060 Për Kualifikimet Kombëtare dhe nenin 23 të Udhëzimit Administrativ MASHT Nr.35/2014 Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë është e obliguar të realizoj procesin e monitorimit dhe të raportoj tek Këshilli Drejtues i AKK-së.
Këshilli Drejtues i AKK-së, në mbledhjen e fundit të datës: 22.12.2025 ka shqyrtuar ankesën dhe përgjigjet e dhëna nga ekipi i ekspertëve, dhe referuar dispozitave ligjore, rekomandimeve të ekipit të ekspertëve të dhëna në raportet vlerësuese përfundimtare për akreditim dhe validim të institucionit aplikues, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014, Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD së AKK, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të vendimit.*

Dr. Besim Mustafa
Kryetar i Këshillit Drejtues
Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve

Vendimi u dërgohet:

- Shoqata e Kontabilisteve të Certifikuar dhe Auditorëve te Kosovës (ShKÇAK) Prishtinë,
- Arkivit të AKK.